

Tiranë më 22.07.2024

**S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“National Development” Sh.p.k**

**KAPITULLI I**  
**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI**

**Neni 1**

**Emri**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“National Development”Sh.p.k**, e cila më poshtë do të quhet **“Shoqëria”**, është themeluar nga ortakët e saj, Shoqëria **“Delta Cooperation And Investment”sh.p.k**, regjistruar në QKB, me Nipt M01726016N,përfaqësuar nga Z.Marenglen Ceci, lindur në Gramsh dhe banues në Tiranë, lindur më 18/03/1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim ID nr. 037299703 dhe nr.personal I10318194C dhe Shoqëria **“NIKI KONSTRUKSION”** sh.p.k, regjistruar në QKB, me NIPT L01501021J, përfaqësuar nga Z.Nikolla Laçi, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, lindur më 25/08/1939, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim ID nr.personal D90825054V.

Ne perputhje me vullnetin e saj te lire dhe mbeshtetur ne Ligjin me Nr. 9901, date 14.04.2008 **“Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”** dhe me Ligjin Nr.131/2015, **“Per Qendrën Kombëtare të Biznesit”** themeluesit e shoqërisë Ortakët e saj, **“Delta Coperation And Investment”** sh.p.k dhe **“NIKI KONSTRUKSION”** sh.p.k miratuan dhe nënshkruan këtë statut të shoqërisë **“National Development”** Sh.p.k.

**Neni 2**

**Forma**

Kjo Shoqëri është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Themeluesit e saj janë persona juridik, që i mbulojnë humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara dhe nuk përgjigjen për humbjet e shoqërisë tregtare.

**Neni 3**

**Baza juridike**

Shoqëria është krijuar në baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise konkretisht ne baze te Ligjit me Nr. 9901, date 14.04.2008 **“Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”** dhe te Ligjit me Nr. 131/2015, **“Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”** dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij Statuti. Ajo ka personalitet juridik dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).



#### **Neni 4 Selia**

Selia e Shoqërisë është në Tiranë në adresën Mëzez, Autostrada Tiranë- Durrës, Km1.5, Godina Delta, Zona Kadastrale 2679, nr. Pasurie 34/86, Mëzez Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Ortakëve. Shoqëria do ta konsiderojë selinë e percaktuar me sipër si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti mund të hape dege, filiale ose shoqëri të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj.

#### **Neni 5 Territori**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

### **KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

#### **Neni 6 Objekti**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

Projektim dhe ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë; 2. Investimin në projekte zhvillimi zonash urbane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi; 3. Shitja e njësive të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimit të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti; 4. Administrimi dhe shfrytëzimi i njësive të gjeneruara nga investimet në projektet e zhvillimit në zonat e turizmit për qëllime rekreative dhe akomoduese; 5. Ofrimi i shërbimit të konsulences në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj. 6. Vlerësim të pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Mund të lidhë kontrata të dyanshme aktivi dhe pasivi me institutet e kreditit të autorizuar nga ligji dhe me shoqëritë dhe firmat private, të japë garanci reale edhe për të tretët dhe gjithçka që është e nevojshme për realizimin e objektivit të veprimtarisë së shoqërisë.

**Neni 7**  
**Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj, në statut ose me vendim të Ortakëve.

**KAPITULLI III**  
**AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQERISE, KONFIDENCIALITETI**

**Neni 8**  
**Fusha e autoritetit te ortakut**

Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut dhe ligjin "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 9**  
**Libri i Shoqerise**

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Konfidencialiteti**

Personat e pranuar në Shoqëri, duhet të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**Neni 11**  
**Dokumentet e destinuar per te tretet**

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuar për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

**KAPITULLI IV**





## KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE TE SHOQERISE

### Neni 12 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10 000 Euro (dhjetë mijë euro),  
cili përbëhet nga 2 (dy ) kuota përkatësisht:

1. Shoqëria “Delta Cooperation And Investment”sh.p.k, regjistruar në QKB, me Nipt M01726016N,vlera e kapitalit të përgjithshëm **5000 euro**, numri i pjesëve 1 kuotë, që përbën 50 % te kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Shoqëria “NIKI KONSTRUKSION”sh.p.k, regjistruar në QKB, me NIPT L01501021J vlera e kapitalit të përgjithshëm 5000 euro, numri i pjesëve 1 kuotë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### NENI 8


Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët. Shoqëria mund ta shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj me vendim të Ortakëve.

### Neni 13 Kuotat

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 kuota.

### Neni 14 Zoterimi i kuotave

Kuotat e shoqërisë zotërohen 50% nga “Delta Cooperation And Investment”sh.p.k, dhe 50 % nga “NIKI KONSTRUKSION”sh.p.k, në vlerën e 2 kuotave.



### Neni 15



## **Menyrat e fitimit dhe te kalimit te kuotave**

Kuotat e shoqërise janë fituar nga ortakët me kontributin e tyre financiar në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e shoqërisë mund të kalojnë lirisht tek personat e tretë me shitblerje me miratimin e Ortakëve të Shoqërisë.

Gjithashtu kuotat e shoqërisë mund të kalojnë me rrugë trashëgimie. Bashkëshortja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortak nepërmjet kalimit të kuotave me vendim të ortakëve dhe sipas kushteve që lejohen në ligj.

Kalimi i kuotave të shoqërise me shitblerje bëhet me kontrate me shkrim dhe të vërtetuar me akt noterial.

## **KAPITULLI V STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

### **Neni 16**

#### **Organet Drejtuese**

Si organe drejtuese të Shoqërisë janë;  
Ortakët e Shoqërisë.

### **Neni 17**

#### **Kompetencat e Ortakeve**

Kompetencat e Ortakëve do të jenë:

- Përcakton politikat tregtare të shoqërisë
- Vendors për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë, kalimin e kuotave, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë
- Emëron dhe shkarkon administratorin e shoqërisë
- Mbikqyrjen e politikave tregtare nga administratori
- Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- Përfaqëson shoqërinë në gjykatë dhe në procedurat e tjera ndaj administratorëve
- Vendors për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Shqyrton bilancin vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendors për ndarjen e dividendëve.
- Vendors për krijimin e degëve (filialeve) ose të perfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizik apo juridik.

### **Neni 18**

#### **Vendim-marrja e Ortakeve.**

Administratori ose eksperti kontabël të autorizuar, dhe nëse ka të tillë, ose likuiduesi mund të propozojnë dhe të kërkojnë shqyrtimin e çështjeve të ndryshme nga ortakët e shoqërisë. Njoftimi bëhet me shkresë ose përmes postës elektronike ku përshkruhet çështja dhe propozimi konkret.

**Neni 19**  
**Administratori dhe kompetencat e tij**

Shoqëria do të ketë një administrator, i cili emërohet nga Ortakët. Administrator i shoqërisë është Znj. Verona Dollaku.

Kompetencat e administratorëve në mënyrë konkrete dhe të detajuar percaktohen në aktin e emërimit.

Administratori, në rast kur nuk është Ortaku i vetëm i Shoqërisë, përveç të tjerave ka të drejtë dhe detyrohet të:

- Te administroje veprimtarine tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Ortaket.
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe librave kontabel te shoqerise.
- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe propozon shperndarjen e fitimeve duke kerkuar per keto miratimin e Asamblese se Pergjithshme.
- Te regjistroje te dhenat e detyrueshme te shoqerise ne QKB
- Te raportoje perpara Ortakeve per realizimin e politikave tregtare te shoqerise
- Te koordinoje veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri
- Te perfaqesoje Shoqerine ne marredhenie me organet shteterore dhe me personat e trete.

Emërimi i administratorit do të bëhet për një afat prej 3 vjecar me te drejte rimerimi.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij dhe eshte i detyruar te demshperbleje shoqerine per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes.


Administratori ka barren e proves për të vërtetuar kryerjen e detyrave sipas standarteve të kërkuara. Emerimi dhe shkarkimi i administratorit bëhet me vendim te Ortakeve te shoqerise.

**KAPITULLI VI**  
**LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, DIVIDENTET**

**Neni 20**  
**Librat e Shoqerise**

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç Librit te Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakëve, nese ne te ardhmen do te kete me shume se nje ortak dhe kapitalin themeltar, si dhe vendimet e ortakut ose te asamblese se ortakëve nese do te kete me shume se nje ortak, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

**Neni 21**  
**Bilanci**





Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar, raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, propozizmet për ndarjen e fitimeve nënkruhen nga administratori dhe miratohen nga Ortaket e Shoqërisë. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

## **Neni 22 Dividentet**

Ortaket e shoqërisë miratojnë llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit, përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit pasi i janë zbritur shumatat e lena menjëherë për: rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga vete Ortaket, fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe, pasi janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme, përcakton dhe dividentin. Ortaket vendosin dhe për ndarjen e dividendit.

## **Neni 23 Marredheniet e Punës**

Marredheniet e punës në shoqëri gjëjnë rregullim në kontratën e punës, në Kodin e Punës dhe në aktet e tjera që kanë dale në zbatim të këtij kodi.

## **KAPITULLI VII LIKUJDIMI dhe PRISHJA E SHOQËRISË.**

### **Neni 24 Mbarimi**

Shoqëria prishet

- me vendim të Ortakëve
- me hapjen e procedurave të falimentimit
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë së saj në QKB
- me vendim të gjykatës

Në të gjitha rastet Ortaku i Shoqërisë duhet të regjistrojë prishjen e shoqërisë në QKB në përputhje me Ligjin Nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

### **Neni 25 Likujdimi i shoqërisë**

Prishja e shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese bëhet me procedurën e likujdimit të shoqërisë kur nuk është nisur procedura falimentimi.

Ky fakt regjistrohet në QKR, duke shtuar tek emri i shoqërisë shënimin "në likujdim"

Per te ndjekur proceduren e likujdimit Ortaket emerojne nje likujdues.  
Nese shoqeria prishet me vendim gjykate, likujduesi emerohet nga Gjykata.  
Shkarkimi i likujduesit behet me te njejten menyre sic behet dhe emerimi i tyre  
Ne rast prishje shoqeria do te perpiqet te aplikojte likujdimin e thjeshtezuar ne perputhje me dispozitat e neneve 204 dhe 206 te Ligjit me Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

## KAPITULLI VII MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT

### Neni 26 Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit ortaket dhe administratori do te perpiqen ti zgjidhin me mirekuptim dhe nese kjo nuk arrihet, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës se Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane, seksionit tregtar.

### Neni 27 Dispozita te fundit

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashte Shqiperise.  
Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles percaktohet nga Ortaket.  
Ky Statut është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

## ORTAKËT E SHOQËRISË

"Delta Cooperation And Investment" sh.p.k  
Administratori

Z.Marenglen Ceci



"NIKI KONSTRUKSION" sh.p.k  
Adminsitratori

Z.Nikolla Laçi

